



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**KOMISIONI PËR BUJQËSI, PYLLTARI, ZHVILLIM RURAL,  
MJEDIS DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR**

**Legjislatura e –III-  
Mbledhja nr. 3-2008  
Prishtinë, më 11.3.2008, ora 14:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

**P R O C E S V E R B A L**

Në mbledhje morën pjesë: Lulzim Zeneli, Zylfi Merxha, Berat Luzha, Elheme Hetemi, Zef Morina, Haset Cakolli, Myrvete Pantina, Selvie Halimi dhe Kosara Nikolić

Munguan: Ibrahim Selmanaj dhe Ali Lajçi

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit : Ahtere Loxha dhe Bajram Badivuku .

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësis, pylltaris dhe zhvillimit rural, Shefki Zeqiri dhe Shaban Dreshaj.

Pjesëmarrsit tjerë: Monitoruesit nga presidenca dhe OSBE.

**Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komisionit Lulzim Zeneli**

**Kryetari hapi mbledhjen dhe propozoi këtë;**

## Rend Dite

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/21 për Ligjin për kooperativat bujqësore.

1.Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2.Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua pa vërejtje.

**Kryetari** pastaj kaloi në pikën e radhës

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/21 për Ligjin për kooperativat bujqësore

**Kryetari** para se ta filloj procedurën e shqyrtimit nen për nen të projektligjit ia dha fjalën përfaqësuesit të ministrisë së bujqësis.z. **Shefki Zeqirit** drejtor i departamentit ligjor në Ministri.

Ai tha se gjatë implementimit të ligjit është pa nevoja për tu ndryshuar dhe plotësuar Ligji për shkak të mangësive që kanë ekzistuar ,ndryshimet janë bërë shkak të skadimit të afatit prej një viti për ri-regjistrimin e Kooperativave ekzistuese shumica e të cilave nuk janë regjistruar brenda afatit të përcaktuar ligjor ,pastaj zvogëlimin e numrit të anëtarëve nëpër kooperativa si dhe te masat ndëshkuese .

**Berat Luzha** kishte vërejtje për formën se si është paraqitur projektligji, sepse konsideroj se do duhej të paraqitej në një kolon edhe ligji ekzistues për të mundur me i bërë krahasimet.

**Kryetari** filloj shqyrtimin nen për nen të projektligjit dhe hapi diskutimin lidhur me nenin e parë ku definicioni Federata ndryshohet si vijon:

**“Federata është bashkim vullnetar i disa kooperativave bujqësore”**

Lidhur me këtë Kryetari hapi diskutimin.

**Zef Morina** mendon se më i qëlluar do të ishte termi Union i shoqatës së kooperativave se sa termi Federatë

**Berat Luzha** vlerësoi se termi federatë është më tepër term politik dhe propozoj të quhet shoqatë .

**Elheme Hetemi** tha se Ligji për Kooperativat e bujqve është hartuar në bashkëpunim me shtetin francez dhe është marë diçka nga modeli i tyre dhe i është përshtat specifikave të Kosovës ,atje quhet federatë dhe mendoj se shoqatë nuk mund ta quajmë, sepse vet statusi i shoqatës ndryshon nga ai i kooperativës dhe federata është bashkimi i të gjitha kooperativave në nivel të vendit ku mbrohen interesat e tyre.

**Përfaqësuesi i ministrisë** theksoi se kemi menduar me qenë ky term ma adekuat për rrethanat tona dhe mentalitetin tonë dhe nëse hyjmë në detale ish dashtë të ndryshohet krejt ligji por ne i kemi bërë vetëm disa ndryshime të vogla dhe nëse e ndërrojmë këtë term do duhej të ndërrohet në tërë ligjin ku përdoret termi federatë.

Në të gjitha shtetet e Unionit evropian e përdorin këtë term dhe ne duhet t'ia përshtatim standardeve evropiane sepse nuk na miratohet ligji nga zyra për integritime evropiane në Qeveri.

**Kosara Nikoliç mendon se bashkimi i unioneve e përbëjnë federatën'.**

**Selviqe Halimi** vlerësoi se pasi me termin federatë nuk ndryshon forma e organizimit dhe qysh prej miratimit të ligjit në vitin 2003 është quajt federatë, atëherë le të mbetet si është sepse nuk e shohim pengesë në punën e mëtejshme .

**Kryetari** vlerësoi se nëse është marrë si model nga shtetet e unionit evropian dhe në shtetet e rajonit përdoret termi federatë , atëherë propozoj që të miratohet amendamenti i propozuar nga ministria përkatëse ashtu si është paraqit.

**Komisioni miratoj amendamentin e parë të Ministrisë lidhur me nenin 1 pa ndryshime .**

**2.Kryetari** pastaj kaloi në shqyrtimin e amendamentit të dytë në të cilën ndryshohet si vijon; që në nenin 2.5 të fshihet teksti „të gjitha kooperativave ekzistuese dhe”.

Pasi që nuk kishte diskutues të paraqitur lidhur me këtë amendament .

**Amendamenti 2 u miratua nga komisioni pa ndryshime .**

**3.Kryetari** pas miratimit të amendamentit të dytë kaloi në shqyrtimin e amendamentit 3, neni 4 ndryshohet si vijon „fshihet dhjetë bujq dhe bëhet 5 bujq.

**Përfaqësuesi i ministrisë** tha se është pa e arsyeshme mu ul numri prej 10 në 5 bujq për themelimin e kooperativave të bujqve, kemi menduar për situatën aktuale me qen ma funksional, sepse 10 bujq ishte më vështir të tubohen.

**Komisioni miratoj pa ndryshime amendamentin 3 lidhur me nenin 4.**

4. **Kryetari** hapi diskutimin lidhur me amendamentin e 4 për nenin 7.3.a ku propozohet të fshihet teksti „nënshkrimin e kërkesës për anëtarësim”.Ai konsideroj se nëse fshihet kjo do të mbetet e pa kuptueshme dhe pika a) dhe pika b) e nenit 7.3 në ligjin ekzistues janë të pa kuptueshme dhe duhet të riformulohen dhe lidhur me këtë hapi diskutimin .

**Përfaqësuesi i ministrisë** sqaroi se kur është hartuar ligji në vitin 2003, aso kohe nuk ka pas ekspert të mirë të formulimit të neneve dhe tha se ne tani kemi konsiderua se duhet fshirë fjalët „me nënshkrimin për anëtarësim” sepse po duplikfikohen gjërat

Lidhur me këtë amendament u paraqiten disa propozime ;

**Zef Morina** vlerësoj se pasi që është fjala për statusin e anëtarit i cili fitohet me themelimin e kooperatives dhe nënshkrimin për anëtarësim, mendoj të riformulohen pika a) dhe b) sepse po duplikohen gjërat.

**Elheme Hetemi** konsideroj se do të ishte më e drejtë të thuhet „me pranimin e kërkesës për anëtarësim nga ana e kooperatives ose në bazë të statutit dhe procedurave që ka.

**Berat Luzha lidhur** me pikën (a) dhe (b) mendon se do të duhej të bëhen 2 nene të veçanta „statusi i anëtarit dhe statusi i kooperativës sepse nuk mund të shkohet me a) dhe b).

**Myrvete Pantina** propozoj mos të fshihet asnjë pikë , sepse pika a) ka të bëjë me themelimin e kooperatives kurse pika b) ka të bëjë me fitimin e statusit të anëtarit të ri .

Po ashtu edhe **përfaqësuesi i ministrisë** nuk u pajtua të ndryshohen këto pika, sepse konsideroj se gjatë implementimit mund të ketë konfuzion.

**Kryetari** vlerësoi se ky ligj bëhet për qytetarin e thjesht dhe duhet të jetë sa më i kuptueshëm .

Ai propozoj që pika a) dhe b) të sintetizohen në një pikë dhe propozoj që të riformulohet si në vijim:”Statusi i anëtarit të ri fitohet pas aprovimit të kërkesës dhe pranimin e të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga statuti.

**Elheme Hetemi** vlerëson se statusi i anëtarit të ri të kooperativës fitohet pas aprovimit të kërkesës për anëtarësim nga ana e Kuvendit të kooperativës, pra të precizohet nga bordi apo kuvendi.

**Selvije Halimi** mendon se duhet precizuar se me çfarë dokumenti i pranon ato dhe cili organ e mer vendimin për pranimin e anëtarëve të rinj..

**Myrvete Pantina** u ndërlidh dhe sqaroi se në pjesën e dytë po të këtij neni thuhet se vendimin për pranimin e anëtarëve të rinj e merë Këshilli drejtues.

**Kryetari** konsideroj që pasi qenka e sqaruar se cili organ e merë vendimin për pranimin e antarëve të rinj propozoj që pika a) dhe b) e nenit 7.3 të sintetizohen në një pikë dhe të riformulohen si në vijim;

**Statusi i anëtarit të ri të kooperatives fitohet pas aprovimit të kërkesës për anëtarësim nga organi kompetent i kooperatives , me të gjitha të drejtat dhe obligimet e anëtarit të kooperatives.**

**Propozimi i kryetarit u miratua njëzëri nga anëtarët e komisionit.**

5.Në vazhdim Kryetari hapi diskutimin lidhur me amendamentin 5 që ka të bëjë me nenin 10.4 ku propozohet të fshihet teksti „mbledhja e jashtëzakonshme “.

**Ky amendament u miratua nga ana e komisionit pa ndryshime.**

**6. Kryetari** vazhdoi në amendamentin 6 dhe pyeti anëtarët se a pajtohen që në nenin 21.1 fjala delikt ekonomik të zëvendësohet me „kundërvajtje”

## **Anëtarët e komisionit me shumicë votash miratuan amendamentin e propozuar nga Ministria.**

**Kryetari** hapi diskutimin lidhur me nenin 21.2 të masat ndëshkimore në të cilën në ligjin ekzistues dënimi me gjobë ka qenë 5000€, tani caktohet minimumi dhe maksimumi i dënimit prej 1000 deri në 5000€.

**Përfaqësuesi i ministrisë** tha se kemi caktua minimumin dhe maksimumin ligjor në mënyrë që gjyqësori varësisht prej shkeljes ta shqiptoj edhe masën e dënimit.

**Zef Morina** konsideron se në këtë rast raporti mes minimumit dhe maksimumit është shumë i lartë dhe mund të lehet mundësi e keqpërdorimit nga ana e gjyqëtarëve ku mund ta shqiptojnë vetëm dënimin më të ultë për shkelje më të larta. Andaj propozoj që dënimet me gjobë të jenë prej 3000 deri 5000€.

**Selviqe Halimi** vlerësoi se pasi në nenin 21.2 janë paraqit 3 raste në të cilën dënohen me gjobë për kundërvajtje prej 1000 deri në 5000, mendoj se propozimi i Zefit që raporti mes minimumit dhe maksimumit mos të jetë kaq i lartë, u pajtua që për rastin e parë të shkoj dënimi me gjobë prej 3000 deri në 5000, nëse kooperativa ushtron veprimtari në cilën nuk është paraparë në statutin e saj dhe nuk është e regjistruar.

**Kurse me dënimet prej 1000 deri në 3000 dënohet për kundërvajtje kooperativa nëse:**

- a) nëse në emërtimin e firmës së vetë nuk e shfrytëzon emërin e kooperatives dhe
- b) nëse nuk mban regjistrin e anëtarëve të Kooperativës.

Lidhur me nenin 7 ku në nenin 23 “Dispozitat kalimtare propozohen të fshihen.

**Kryetari** pyeti anëtarët se a pajtohen të miratohet ky propozim.

**Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e komisionit dhe pas diskutimeve të bëra lidhur me propozimet për Projektligjin plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për kooperativat e bujqve komisioni u nxorr ky:**

### **Përfundim.**

1. Komisioni pas shqyrtimit të projektligjit për ndryshime në Ligjin për Kooperativat e Bujqve, si komision përgjegjës dhe referues, Kuvendit i propozon këto rekomandime:

## **Amendamenti 1**

### **Neni 4**

Neni 7.3 ,pika (a ) dhe (b ) riformulohen si në vijim :

**“Statusi i anëtarit të ri të kooperativës fitohet pas aprovimit të kërkesës nga organi kompetent i kooperativës, me të gjitha të drejtat dhe obligimet e anëtarit të kooperativës.**

## **Amendamenti 2**

**Neni 6:**

Neni 21.2 riformulohet :

**21.2. Me dënim me gjobë prej 3000 deri 5000 euro do të dënohet për kundërvajtje kooperativa e bujqve nëse ushtron veprimtari të cilat nuk janë të parapara në statutin e saj dhe për të cilat nuk është e regjistruar (neni 2.2),**

**21.3. Me dënim me gjobë prej 1000 deri 3000 euro dënohet për kundërvajtje kooperativa e bujqve nëse:**

- a) në emërtimin e firmës së vet nuk e shfrytëzon emrin e kooperativës dhe
- b) nëse nuk mban regjistrin e anëtarëve të kooperativës (neni 7.3).”

### **Të ndryshme**

**Kryetari** njoftoj komisionin lidhur me iniciativën e organizatës ndërkombëtare për mjedis REC për organizimin e një tryeze të punës lidhur me procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe vlerësimit strategjik mjedisor , tryeza e punës do të mbahet në hotelin Iliria me 18.03.2008.

Takimi përfundoi në orën 15,15 min.

Procesverbalin e hartoj

Ahtere Loxha

Kryetari i Komisionit

**Lulzim Zeneli,**

